

# PROTOKOLLI I INFORMIMIT PËR RASTET QË LIDHEN ME EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM DHE TERRORIZMIN



Maj, 2021

**Autorët: Dr. Nikola Dujovski**  
**Redaktor: MA Dragan Sekulovski**

Ky publikim u përgatit brenda kornizës së projektit “Ndërtimi i rezistencës kundër terrorizmit të dhunshëm dhe ekstremizmit përmes kapaciteteve të përforcuara të gazetarëve, mediave dhe zyrtarëve qeveritarë”, financuar nga Evropa brenda programit STREVE Global (Forcimi i Reziliencës ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm -STRIVE Global) përmes Hedayah (Qendra Ndërkombëtare e Ekselencës për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm)

Përmbajtja e këtij publikim është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe SHGM, IEP dhe Instituti Konica dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyrojnë pikëpamjet dhe mendimet e Bashkimit Evropian.



**Hedayah**  
countering violent extremism

# PËRMBAJTA

<b>HYRJE</b>	<b>3</b>
<b>1. FORCIMI I BASHKËPUNIMIT MIDIS INSTITUCIONEVE SHTETËRORE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK</b>	<b>5</b>
<b>2. INFORMACIONI CILËSOR - THELBËSOR PËR MBROJTJEN E POPULLATËS DHE PARANDALIM NGA VIKTIMIZIMI SHITESË</b>	<b>7</b>
2.1. Pse të shmangim sensacionalizmin?	10
2.2. Raportimi për viktimat dhe të lënduarit	13
2.3. Mbrojta speciale e fëmijëve	13
<b>3. MEDIAT - NJË HALLKË E RËNDËSISHME NË PARANDALIMIN DHE TRAJTIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE TERRORIZMIT</b>	<b>14</b>
<b>4. QËNDRONI TË SIGURT FIZIKISHT, NË ASPEKTIN DIGJITAL DHE PSIKO-SOCIA</b>	<b>15</b>
<b>LITERATURA E SHFRYTËZUAR</b>	<b>17</b>

## HYRJE

Republika e Maqedonisë së Veriut gjendet në një periudhë të ndjeshme zhvillimi në të cilën duhet të tregojë aftësinë e saj objektive dhe subjektive për të përbushur standardet e larta, jo vetëm si anëtare e NATO-s, por edhe si një vend që po përgatitet seriozisht për negociata për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi (EDHT) paraqesin një temë aktuale në shoqërinë tonë, ndoshta njësoj si në të gjitha vendet përreth dhe madje edhe në botë. Çdo vend zgjedh mënyrat e veta për t'u përgatitur më mirë për valën e ardhshme të aktiviteteve që mund të çojnë në akte terroriste dhe për të ndërtuar politika për të parandaluar dhe mbështetur agjencitë qeveritare që punojnë për të parandaluar EDHT. Në të njëjtën kohë, secili vend po punon ngushtë me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare të sigurisë për të shkëmbyer informacione në lidhje me EDHT, me çka përmirëson ndjeshëm kapacitetin e autoriteteve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit (PEDHLKT).

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut tashmë kemi pasur raste në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm që çon në akte terroriste. Nga raste të tilla mund të nxirren shumë informacione dhe mësim të dobishme se si të veprohet në të ardhmen, si të përgatiten institucionet, si të ndërtohet një politikë cilësore për të parandaluar dhe penguar këto veprime jashtëzakonisht serioze dhe të rrezikshme me pasoja të paparashikueshme për shoqërinë e Maqedonisë së Veriut. Rastet e njohura për publikun si “Monstra”, “Kodra e trimave”, “Celula” dhe të tjera, flasin mjaft se EDHT ka “tokë pjellore” të pjesshme dhe se nevojiten aktivitete shtesë në mënyrë që të merremi më me sukses me këtë fenomen negativ social.

“Kur një shoqëri po përballet me ngjarje dramatike, të tilla si sulmet terroriste, njerëzit kanë nevojë urgjente për informacione. Ata duan të dinë se çfarë po ndodhë dhe si mund të preken ata ose komuniteti i tyre. “Më vonë - kur kërcënimi, rreziku ose kriza e menjëhershme ka mbaruar - ekziston nevoja për të kuptuar pse ngjarjet janë zhvilluar deri në pikën ku ato kanë shkaktuar pasoja dhe çfarë mund të bëhet për të parandaluar sulmet në të ardhmen.”<sup>1</sup>

1 A Handbook on Reporting Terrorism, p. 8.

Shteti ka përgjegjësinë kryesore të marrë masa dhe aktivitete për të parandaluar dhe luftuar EDHT, por gjithmonë duke pasur parasysh respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Në të njëjtën kohë, nuk duhet të mungojë mbështetja që organet shtetërore duhet të marrin nga shoqëria në tërësi, dhe veçanërisht nga media nëse duam sukses në luftën kundër këtij fenomeni.

Media ka një rol shumë të përgjegjshëm, por edhe shumë të rëndësishëm për të informuar publikun dhe për të siguruar analiza të ngjarjeve të tilla. Raportimi për EDHT është një sfidë për punonjësit e mediave në të gjithë botën. Raportimi në kohë reale dhe presioni për të përmbushur afatet e dakorduara duhet të jenë në përputhje me etikën profesionale. Deri më tani, është bërë shumë pak për të forcuar kapacitetet e gazetarëve në këtë fushë, si në Maqedoninë e Veriut ashtu edhe në rajon, në Evropë e madje edhe në botë.

E vetëdijshme për rolin e saj përgjegjëse, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë me partnerët e saj zhvilloi disa trajnime për gazetarë të rinj në tema që lidhen me parandalimin e EDHT dhe përgatiti këtë protokoll që shpresojmë të jetë një mjet i dobishëm për të gjithë të përfshirë në shkëmbimin e informacioneve në lidhje me EDHT.

Duke u nisur nga premisa themelore që çdo institucion (pavarësisht nëse është qeveritar apo joqeveritar) ose shoqatë e qytetarëve dhe së fundmi qytetari si hallka më e rëndësishme në një shoqëri të organizuar, do të japin kontributin dhe shenjën e tyre në përmbushjen e standardeve minimale të nevojshme për komunikim dhe bashkëpunim, ne kemi përgatitur Protokollin e për informimin në lidhje me rastet që kanë të bëjnë me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.

# FORCIMI I BASHKËPUNIMIT MIDIS INSTITUCIONEVE SHTETËRORE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK

Ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi në dekadën e kaluar janë bërë tema veçanërisht aktuale në botë dhe në vendin tonë. Parandalimi dhe pengimi i këtyre dukurive negative shoqërore është i mundur vetëm përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me të gjitha institucionet dhe organet kompetente, si dhe me sektorin civil. Shkëmbimi i informacioneve cilësore dhe në kohë do të kontribuojë në informimin e saktë të publikut, si dhe në ndërtimin e mekanizmave për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së shtetit dhe sigurisë së qytetarëve. Praktikën më të mira botërore shkojnë në drejtim të forcimit të bashkëpunimit midis të gjithë aktorëve të përfshirë. Sfidat janë shumë serioze dhe çdo palë e interesuar është e detyruar të veprojë me kujdes të veçantë dhe një nivel të lartë profesionalizmi, ndërsa duke u kujdesur për integritetin e tyre personal dhe profesional.

Ka shumë shembuj dhe vende në botë ku bashkëpunimi midis punonjësve mediatik dhe anëtarëve të institucioneve të sigurisë është shumë i vështirë. Sidoqoftë, është veçanërisht e rëndësishme të përmendet fakti që gjatë përgatitjes së këtij Protokollit dhe bisedimeve të vazhdueshme me zyrtarë të Qeverisë dhe punonjësit mediatik, krijohet përshtypja se një bashkëpunim i tillë (veçanërisht midis Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe mediave) është në një nivel të lartë dhe zhvillohet me besim të ndërsjellë dhe mbështetje profesionale. Aktivitetet e shumta të përbashkëta që realizohen ndërmjet përfaqësuesve të institucioneve shtetërore dhe punonjësve mediatik do të mundësojnë rritjen e besimit dhe shkëmbimin më të lehtë të informacioneve.

Informacionet që i posedojnë shërbimet e sigurisë janë të rëndësishme për qytetarët, prandaj bashkëpunimi me mediat është e një rëndësie kryesore për informim korrekt, në kohë dhe të saktë. Është gjithashtu e rëndësishme që punonjësit e mediave të kuptojnë procedurat për marrjen e informacioneve nga policia dhe shërbimet e tjera të sigurisë, si dhe nga të autorizuarit për bashkëpunim me mediat. Dhe, sigurisht, informacionet duhet të përdoren me përgjegjësi, pa rrezikuar jetën e nëpunësve të policisë, gazetarëve, të mbijetuarve ose operacionit policor, nëse nuk ka mbaruar ende. Ka disa arsye pse policia dhe shërbimet e tjera të sigurisë duhet të zhvillojnë marrëdhënie të mira me mediat:<sup>2</sup>

<sup>2</sup> A Handbook on Reporting Terrorism, p. 16.

- **Mediat mund të jenë një partner** i rëndësishëm në luftën kundër EDHT;
- **Mediat shpesh kanë një rol** shumë të rëndësishëm që përcakton edhe rrjedhën e ngjarjeve dhe sjelljen e publikut, kështu që ato nuk mund të injorohen;
- **Mediat përgjithësisht konsiderohen të jenë më të besueshme si një burim informacioni**, pikëpamjesh dhe mendimesh dhe për këtë arsye është një pasqyrë e shkëlqyeshme për përcjelljen e mesazheve pozitive;
- **Mediat kanë potencial për t'ju bërë të dukeni mirë ose keq.**

Policia dhe mediat porositen të bashkëpunojnë mes vete në kryerjen e detyrave të tyre (të kujdesen për sigurinë dhe të informuarit e qytetarëve) - çelësi është të krijohet një lidhje e fortë para ndodhjes së një akti terrorist ose veprimi në lidhje me ekstremizmi i dhunshëm. Edhe policia dhe mediat duhet të njohin protokollet dhe politikat themelore të institucionit tjetër dhe ndoshta më e rëndësishmja - të respektojnë politikat e tilla.

Në këtë kuptim, është e rëndësishme të vendoset një bashkëpunim i vazhdueshëm në nivelin e grupeve të punës, të cilat do të takohen herë pas here dhe do të shkëmbejnë të dhëna, por gjithashtu do të kujdesen për tejkalimin e problemeve, shqetësimeve ose keqkuptimeve eventuale. Një qasje e ndryshme “evropiane” ndaj çështjeve mund të parashikojë organizimin e trajnimeve të përbashkëta, seminareve, tryezave të rumbullakëta për të diskutuar tema me interes të përbashkët të cilat, pa dyshim, do të çojnë në forcimin e partneritetit.

Mos harroni kurrë se ka pasur dhe do të ketë situata në të cilat policia, për arsye të kuptueshme, do të kërkojë durim, kur bëhet fjalë për ndarjen e të gjitha informacioneve. Kjo mund t'i referohet një ngjarjeje specifike, por edhe të lidhet me rangun dhe pozicionin e punës së personit që kërkon informacionin.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mediat dhe punonjësit e mediave njihen si aktorë të rëndësishëm në procesin e parandalimit të EDHT. Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm i njeh ata midis aktorëve të tjerë të shoqërisë civile si OJQ-të, udhëheqësit fetarë, komunitetet lokale, të rinjtë, gratë dhe të tjerët.<sup>3</sup> Në fakt, trajnimet për punonjësit e mediave që janë realizuar në periudhën e kaluar, kanë për qëllim përmbushjen e iniciativave të Strategjisë Kombëtare për PEDH.<sup>4</sup>

3 Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, f. 33;

4 Shih më shumë në Strategjinë Kombëtare, f. 32;

## INFORMACIONI CILËSOR – THELBËSOR PËR MBROJTJEN E POPULLATËS DHE PARANDALIM NGA VIKTIMIT SHTESË

Informacioni cilësor është e një rëndësie thelbësore për qetësimin e tensioneve që janë pothuajse gjithmonë pasojë e rasteve të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Gjithmonë mbani në mend se qëllimi kryesor i atyre që kryejnë sulme terroriste të iniciuara me elemente të ekstremizmit të dhunshëm është që të shkaktojnë panik shtesë në publik, të lënë një imazh që institucionet janë të paafta për të parandaluar dhe trajtuar akte të tilla të dhunshme dhe për të shkakuar vëmendje ndërkombëtare të orientuar drejt grupit të tyre terrorist dhe vendit në të cilin është realizuar sulmi.

Prandaj, është shumë e rëndësishme të bashkëpunoni me autoritetet shtetërore kompetente dhe të merrni informacione të verifikuara dhe të sakta dhe, pavarësisht nga pasojat, ato duhet t'i komunikohen publikut me kujdesin e duhur për të gjitha aspektet e ndryshme të atij informacioni. Jini veçanërisht të kujdesshëm për të shmangur lajmet e bujshme. Ndërkohë, presioni i madh mbi media për të tërhequr lexues dhe shikues - i ballafaquar me valë të vazhdueshme të transformimit teknologjik dhe financiar - mund t'i tundojë mediat të përqendrohen në dhunë dhe sensacionalizëm dhe të jenë të parët që të botojnë lajmet dhe thashethemet tronditëse, madje edhe para se të verifikojnë saktësinë e tij.<sup>5</sup>

Sa janë të dobishme për njerëzit raportimet që përhapin frikë? Deri në çfarë mase korrespondon raportimi me narrativin ekzistues ose idenë mbizotëruese të “kush është një terrorist”? Sigurisht, fjalët e përdorura, shembujt e dhënë, dhe fotografitë dhe filmimet e treguara duhet të jenë informuese e jo të bujshme.

**Kur jeni në vendin e ngjarjes:** Edhe kur jeni të parët në vendin e ngjarjes, para së gjithash kujdesuni për sigurinë tuaj personale dhe të njerëzve që janë me ju, dhe vetëm atëherë siguronit informacion cilësor nga vendi i ngjarjes. Në çdo kohë, binduni urdhrave të personelit të sigurisë që ofrojnë siguri në vendin e ngjarjes. Gjithmonë prisni për konfirmimin e pasojave të sulmit dhe inkurajoni personelin e sigurisë të bashkëpunojë me ju.

5 Terorizam I mediji. Priručnik za novinare, p. 3;

Kushtojini vëmendje të veçantë rekomandimeve të në vijim:<sup>6</sup>

- 1 Shmangni zbulimin e informacioneve kritike në lidhje me situatat** aktuale të pengmarrjes, përveç nëse siguria e pengjeve nuk cenohet më dhe ndërprerja e krizës është konfirmuar nga më shumë se një burim zyrtar ose ndarja e informacionit është e nevojshme për të mbrojtur sigurinë e popullatës në afërsi;
- 2 Shmangni transmetimin e operacioneve** policore derisa ato janë ende në vazhdim;
- 3 Shmangni shfaqjen e skenave me pasoja të rënda** për jetën dhe shëndetin e popullatës dhe/ose panik në njerëz.
- 4 Mundohuni të ktheheni në programet e zakonshme televizive** sapo të njoftohet informacioni bazë për aktin terrorist;
- 5 Përmbahuni nga realizimi dhe transmetimi i intervistave me terroristët** (kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se një nga qëllimet kryesore të terroristëve është të shkaktojë frikë dhe panik në mesin e popullatës, dhe paraqitja e tyre në televizion do të thotë konfirmim se ndikimi i tyre është i madh dhe se shërbimet e sigurisë kanë dështuar për t'i ndaluar ata në qëllimin e tyre);

Të dobishme mund të jenë edhe këshillat në vijim:<sup>7</sup>

- 1 Qëndroni të sjellshëm në çdo kohë,** deklaroni se jeni gazetar dhe mbani letrat e akreditimit me vete;
- 2 Qëndroni të qetë dhe profesional;**
- 3 Respektoni udhëzimet e nëpunësve policorë;**
- 4 Siguroni numrin e telefonit të njërit prej oficerëve të lartë të policisë dhe theksoni** që do të raportoni menjëherë nëse sulmoheni ose pengoheni të punoni;
- 5 Shmangni konfrontimin:** Gjithmonë kushtojini vëmendje sjelljes dhe gjendjes shpirtërore të nëpunësve policorë para se të kërkonte deklaratën e tyre ose t'i përfshini ata në diskutim;

6 Më shumë shihni tek: Benhamou, J: 2020, p.5;

7 A Handbook on Reporting Terrorism, p. 20-21.



- 6 Pyete veten pse po e mbulon këtë ngjarje?** Cili është motivimi juaj? Kush është redaktori juaj?
- 7 Studioni dhe kuptoni ligjet dhe aktet** tjera që kanë të bëjnë me mediat dhe sigurinë;
- 8 Bëhuni të vetëdijshëm për nevojën e ekuilibrit** midis sigurisë dhe profesionalizmit;
- 9 Në mënyrë të kryqëzuar kontrolloni dhe konfirmoni informacionet;**
- 10 Kujdesuni për konfidencialitetin** e atyre burimeve që Ju kanë kërkuar të mos zbuloni burimin dhe do të rrezikoheshin nëse do të zbuloheshin (nga shumica e burimeve përpikuni të siguron një video-filmim, veçanërisht nëse bëhet fjalë për përfaqësues të institucioneve të sigurisë që ndajnë informacione zyrtare);
- 11 Mos i rrezikoni burimet e juaja;**
- 12 Shmangni zmadhimin,** glorifikimin e akteve terroriste;
- 13 Bëni një analizë të thellë të rreziqeve** për situatën në të cilën jeni, jini të vetëdijshëm për pasojat dhe përgatituni të merreni me rreziqet.

**Kur nuk jeni në vendin e ngjarjes:** Kur merrni informacione në lidhje me një rast ekstremizmi të dhunshëm dhe terrorizmi nga një redaksi tjetër dhe media botërore, qasuni me kujdes dhe gjithmonë kontrolloni informacionin nga burime të shumta që ju besoni. Mos harroni se informacioni më i saktë sigurohet gjithmonë nga shërbimet e sigurisë ose agjencitë e zbatimit të ligjit (zyra e prokurorit publik në rastin tonë ose autoritete të tjera të sigurisë sipas ligjit të vendeve të tjera). Nëse ngjarja ka ndodhur në Maqedoninë e Veriut, përdorni kanalet e bashkëpunimit tashmë të vendosura me policinë dhe organet e tjera shtetërore. Kontrolloni të gjitha informacionet që do të merrni, për të cilat institucionet kompetente ende nuk kanë lëshuar një deklaratë zyrtare. Ka shumë shembuj në praktikë kur gazetarët marrin informacione të pasakta që kanë për qëllim të shkaktojë panik në mesin e popullatës.

## 2.1. PSE TË SHMANGIM SENZACIONALIZMIN?

Pavarësisht nga burimi i informacionit, komunikimi që keni realizuar me shërbimet e sigurisë dhe me kolegët tuaj duhet të jetë në drejtim të informacionit të vërtetë, të saktë, në kohë dhe cilësor që do të transmetohet pa sensacionalizëm ose dëshirë për të tërhequr “vëmendjen e publikut” me tituj bombastikë ose përshtypjet tuaja personale në lidhje me ngjarjen.

Mediat dhe punonjësit mediatik shpesh vihen në një pozitë që të akuzohen për sensacionalizëm në raportimin dhe transmetimin e sotëm të informacionit dhe lajmeve. Gazetarët janë kritikuar për ekzagjerimin e fakteve në emër të marrjes së vlerësimeve më të larta ose më shumë abonimeve në gazeta. Internet portalet akuzohen se kanë shkruar tituj bombastikë që më vonë do të konfirmohen se nuk kanë lidhje me tekstin, por janë shkruar për të rritur lexueshmërinë dhe vizitën e faqeve të internetit ose për të shitur reklama. Por, a janë pretendimet të drejta? Si të shmangen akuzat ose pasojat e tilla të padëshiruara si për gazetarin ashtu edhe për mediumin?<sup>8</sup>

- 1 **Gjithmonë përqendrohuni në informacionin e saktë dhe të verifikuar**, gjegjësisht në “ngjarje” të vërtetë.
- 2 **Mos e teproni me faktet.** Secili gazetar dëshiron të shohë shkrimin e tij në ballinë të gazetës ose në terminin goditës të lajmeve. Kjo mund të çojë në tundimin që historia të tingëllojë më e madhe nga sa është në të vërtetë.
- 3 **Vini re listën për raportim të drejtë.**<sup>9</sup>
- 4 **Mund të përdorni gjithashtu fjalë si “kaos” ose “tronditës”,** por vetëm nëse mund t’i mbështesni ato me fakte. Sigurisht, kjo është terminologji që duhet ta përdorni shumë rrallë, pra vetëm në situata të jashtëzakonshme kur jeni të sigurt se ka ndonjë ngjarje në lidhje me EDHT që ka shkaktuar dëme ose pasoja të konsiderueshme në jetën dhe shëndetin e njeriut;

<sup>8</sup> <https://www.thebalancecareers.com/media-sensationalism-in-today-s-news-coverage-2315287>, e qasur më 14 prill 2021.

<sup>9</sup> Më shumë për listën për raportimet e drejta shih në: Halbrook, Glenn. 2020, i mundshëm në <https://www.thebalanceeveryday.com/how-to-avoid-media-bias-in-political-news-stories-2315159>, i qasur më 14 prill 2021;

**5** **Qëllimi juaj gjatë informimit është të tregoni - jo të thoni.** Qasuni në një mënyrë të ekuilibruar dhe lejoni personat e përfshirë ose të lidhur me ngjarjen dhe lërin zërat e tyre të pasqyrojnë situatën më shumë sesa i juaji;

**6** **Qasuni lajmit duke respektuar integritetin Tuaj personal dhe profesional dhe gjykoni** vetë nëse informacioni është “i vlefshëm” për botim apo thjesht një mënyrë e lirë për të përmbushur nevojat e lexuesve ose të redaktorit;

Përgjegjësia shoqërore kundrejt sensacionalizmit kërkon që ne të përmbahemi nga përdorimi i termave që mund të përgjithësojnë ose stigmatizojnë. Në veçanti, duhet të shmangen termat për përcaktimin e terrorizmit si: *islamik, i krishterë, hebre* ose autorët e një akti terrorist si: *anëtarët e Islamit, anëtarët e Krishterimit, anëtarët e Judaizmit* etj.<sup>10</sup> Thirrja e panevojshme ose “drejtimi i gishtit” drejt një komuniteti të tërë etnik ose një grupi fetar mund të çojë në dhunë që pothuajse gjithmonë drejtohet ndaj qytetarëve të pafajshëm.

Në këtë mënyrë, i gjithë komuniteti stigmatizohet vetëm sepse ata ndajnë disa vlera me autorin e veprës që nuk janë karakteristika personale ose besime, por synojnë të jetojnë në një sistem të caktuar politik, ngjyrë lëkure, përkatësi etnike ose vijnë nga mjedis i njëjtë ose i ngjashëm kulturor-historik.

Kualifikimet e formuluar në mënyrë jo konsistente mund të tregojnë sipërfaqësinë, injorancën, madje edhe raportimi i tillë të vlerësohet si i dashakeqës, duke shkaktuar dëme në shumë nivele.<sup>11</sup>

Gjithmonë të keni parasysh se sensacionalizmi nuk vlerësohet në planin afatgjatë. Ekzistojnë disa këshilla të dobishme se si të luftoni kundër tij, që veçanërisht ka të bëjë me redaktorët.<sup>12</sup>

<sup>10</sup> Izveštavanje o terorizmu i nasilnom ekstremizmu. Smjernice za novinare, str. 8

<sup>11</sup> Ibid, 8-9;

<sup>12</sup> <https://obsidianpr.com/4-ways-to-combat-sensationalism-in-the-media/>, i qasur më 21 prill 2021;

- 1 Jini të vetëdijshëm.** Gjithmonë jini të vetëdijshëm për atë që po ndodh në media dhe ndiqni të gjithë mbulimin që lidhet me lexuesit, shikuesit, klientët tuaj;
- 2 Përgjigjuni.** Gjithmonë përgjigjuni akuzave ose “historisë”. Të qëndroni “pa koment” është opsioni më i keq;
- 3 Edukoni.** Informoni gazetarët se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar gjatë aksesimit me informacione të ndjeshme, veçanërisht nëse ato kanë të bëjnë me EDHT. Ndiqni sjelljen e tyre për t’u siguruar që ata nuk do të përsërisin të njëjtat gabime herën tjetër;
- 4 Përsëritni.** Mediat sociale lejojnë që lajmet të përhapen si zjarr - veçanërisht lajmet që janë kontroverse ose të cilat mund të shkaktojnë përçarje. Kjo do të thotë që informacioni burimor - i vërtetë apo i rremë - është i gjallë dhe është larg nga transmetimi drejtpërdrejt ose postimi origjinal në blog. Luftoni dezinformimin dhe sensacionalizmin derisa rrëfimi të kthehet në rrugën e duhur, domethënë derisa e vërteta të përcillet plotësisht, saktë dhe në mënyrë korrekte.

Në situatat kur duhet të përgatisni një histori për një ngjarje që ka të bëjë me EDHT, gjithmonë kushtojini vëmendje rëndësisë së bashkëbiseduesit. Njohësit e mirë të EDHT dhe të politikave, të cilat ndërmerren për ta parandaluar dhe luftuar të njëjtën, do t’ju japin gjithmonë deklaratatë të matura dhe të moderuara, pa ju tërhequr në pretendime apo lajme të bujshme. Profili i bashkëbiseduesve mund të jetë vërtetë i gjerë. Nga analistët e sigurisë, politik, social dhe madje edhe psikologjik, e gjithë kjo në mënyrë që të kuptohet ana e gjerë e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Në rast të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit që i atribuohet përkatësisë fetare, bashkëbiseduesit duhet të kërkohen në komunitete fetare të regjistruara, zyrtare, pra një bashkëbisedues i besueshëm dhe relevant nga ato komunitete. Edhe në këtë rast, bëni kujdes të veçantë kur zgjidhni bashkëbiseduesit, sepse ekziston rreziku real i deklaramit të përfaqësuesve përkatës të disa personave të marginalizuar që nuk kanë reputacion ose ndikim në komunitet ose që ata të jenë përfaqësues të atij komuniteti, që nuk korrespondojnë me situatat reale.<sup>13</sup>

13 Izveštavanje o terorizmu i nasilnom ekstremizmu. Smjernice za novinare, str. 8-9;

## 2.2. RAPORTIMI PËR VIKTIMAT DHE TË LËNDUARIT

Sulmet terroriste shkaktojnë dëme të mëdha. Ndonjëherë sulmet e tilla janë të kufizuara vetëm në shkaktimin e dëmit material dhe dërgimin e mesazheve “politike”. Fatkeqësisht, ka shembuj të shpeshtë kur shënjestra e sulmit është popullata e pafajshme. Sipas Udhëzimit për raportim etik për ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, mediat duhet të mbajnë llogari për të mbrojtur dinjitetin e viktimave, të familjeve të tyre dhe të personave që janë të prekur nga ngjarjet traumatike.<sup>14</sup> Këto janë situata veçanërisht të ndjeshme në të cilat të gjithë të përfshirë duhet të vepronë me kujdes dhe respekt të duhur për viktimat dhe të plagosurit. Gjithmonë lini publikimin e identitetit të tyre tek autoritetet zyrtare, transmetoni deklaratat e tyre drejtpërdrejt pa komente dhe këmbëngulni për të marrë një deklaratë me shkrim nëse nuk ka thirrje të drejtpërdrejtë. Postimi i fotove ose video filmimeve të vendit të ngjarjes duhet të jetë një ekuilibër midis dinjitetit të viktimave dhe/ose të plagosurve dhe familjeve të tyre dhe interesit publik.

Kurdoherë që keni një dilemë në lidhje me mënyrën dhe nevojën për të botuar informacion në lidhje me viktimat dhe/ose të plagosurit, këshillohuni me redaktorin.

## 2.3. MBROJTJA SPECIALE E FËMIJËVE

Fëmijët janë një kategori e pambrojtur që gëzon mbrojtje shtesë në përputhje me legjislacionin vendas dhe konventat ndërkombëtare. Kur raportoni për të miturit, mbani në mend praktikat e mira dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve<sup>15</sup>, të udhëhequr nga interesat më të mira të fëmijës.

Asnjëherë mos zbuloni identitetin e fëmijës, pa marrë parasysh se në çfarë cilësie është i lidhur me krimin - dëshmitarë, viktimë, autorë të krimit. Gjithmonë të jeni të vetëdijshëm për pasojat që mund të rezultojnë nga publikimi i të dhënave, fotografive, videove në lidhje me fëmijët, dhe veçanërisht ankthin, frikën, humbjen e dinjitetit ose rrezikun.<sup>16</sup> Gjatë raportimit për fëmijët është e nevojshme të përdorni një fjalor shembullor dhe të përdorni fjalë të zgjedhura, me të cilat fëmijët nuk do të etiketohen ose diskriminohen.

14 <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/05/ALB-upatstvo-za-profesionalno-izvestuvanje-za-nasilstvo.pdf>, i qasur më 29 prill 2021.

15 <http://www.childrensbassy.org.mk/WBStorage/Files/konvencija%20celosna.pdf>, i qasur më 10 prill 2021.

16 Izveštavanje o terorizmu i nasilnom ekstremizmu. Smjernice za novinare, str. 7.

## MEDIAT – NJË HALLKË E RËNDËSISHME NË PARANDALIMIN DHE TRAJTIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE TERRORIZMIT

Sa është i dobishëm raportimi për njerëzit që përhapin frikë? Deri në çfarë mase korrespondon raportimi me narracionin ekzistues ose idenë mbizotëruese të asaj se “kush është një terrorist”? Sigurisht, fjalët e përdorura, shembujt e dhënë, si dhe fotografitë dhe pamjet e treguara duhet të jenë informuese, jo të bujshme.<sup>17</sup>

Sipas Aleksander Spenser, qëllimi kryesor i terroristëve nuk është kryesisht dhuna ose vrasja e qytetarëve të pafajshëm, por më tepër shkaktimi i panikut dhe pasigurisë në mesin e popullatës, si dhe përhapja e mesazhit të grupit terrorist përmes informacionit në lidhje me aktin e dhunshëm.<sup>18</sup> Spenser i analizon marrëdhëniet midis grupeve terroriste dhe mediave, gjegjësisht punonjësve mediatik, përmes prizmit të “strategjisë për komunikim me mediat” të terroristëve dhe mbulimit mediatik real, përmes tre qëllimeve:

- a) Tërheqja e vëmendjes;
- b) Transmetimi i mesazheve të grupit terrorist në mënyrë që të fitojë simpatinë e publikut për arritjen e qëllimeve të tyre; dhe
- c) Përhapja e frikës dhe panikut në mesin e popullatës.

Rrjetëzimi i më shumë institucioneve në zhvillimin e politikave për të parandaluar EDHT do të japë rezultate më të mëdha se më parë. Institucionet shtetërore nuk duhet të harrojnë, por ato nuk duhet të privohen nga bashkëpunimi me OJQ-të, mediat, komunitetet fetare dhe grupet religjioze, institucionet arsimore dhe të tjerët që mund të ndihmojnë në gjetjen e politikave më të suksesshme për të parandaluar këtë fenomen social negativ.

Roli i mediave mund të ketë rëndësi largpamëse edhe në kuptimin pozitiv dhe negativ. Kjo është arsyeja pse është e një rëndësie të veçantë të vendosen marrëdhënie të ngushta dhe kontakte të vazhdueshme midis autoriteteve në mënyrë që të gjithë të kuptojnë dhe pranojnë rolin e njerëzve nga të cilët varet vërtet lufta kundër EDHT.

<sup>17</sup> Terorizam I mediji. Priručnik za novinare, p. 3;

<sup>18</sup> Spenser, A. (2012). Lessons Learnt: Terrorism and the Media (Ser. 4). Swindon, Wiltshire: Arts & Humanities Research Council, p.8

Mediat gjithashtu mund të luajnë një rol kryesor në edukimin e të rinjve, veçanërisht gazetarëve të rinj ose studentëve të gazetarisë, të cilëve duhet t'u jepet njohuri e përshtatshme që do t'i ndihmojë ata që në fillimin e karrierës të dallojnë “të mirën” nga “e keqja” ose të vërtetën nga lajmi i rremë. Ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi shpesh u drejtohen të rinjve, kryesisht studentëve, të cilët kanë qasje pothuajse të pakufizuar deri te informacionet dhe lehtë mund të bëhen viktima të lajmeve të rreme.

## 4 QËNDRONI TË SIGURT FIZIKISHT, NË ASPEKTIN DIGJITAL DHE PSIKO-SOCIAL

Siguria e gazetarëve dhe punonjësve të mediave është gjithmonë një temë aktuale dhe është e nevojshme të merren masa proaktive për mbrojtje dhe trajnim shtesë për një qasje reale ndaj çështjeve komplekse të sigurisë personale.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë shumë akte ligjore që rregullojnë mbrojtjen shtesë të gazetarëve, si dhe një Doracak për sigurinë e gazetarëve gjatë ngjarjeve me rrezik të lartë<sup>19</sup>, i cili rregullon në detaje çështjet e sigurisë së gazetarëve. Në Doracak janë dhënë në një mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe të thjeshtë të gjithë informacionet që mund të përdoren nga punonjësit e mediave në rast rreziku<sup>20</sup>:

- Si duhet të veprojnë gazetarët kur sulmohen në një tubim publik;
- Si të veprojnë gazetarët kur sulmohen në hapësirën e Internetit;

Siguria e punonjësve të mediave është një sfidë për të cilën duhet të angazhohen të gjithë që janë të përfshirë në punën e tyre ose bashkëpunojnë me ata. Njëra prej mënyrave se si mund të sigurohet mbështetje për të minimizuar cenimin e gazetarëve është të zhvillohen bërfaqë para, gjatë dhe pas raportimit për një ngjarje të lidhur me EDHT:<sup>21</sup>

<sup>19</sup> Breshkovski, Angellovski dhe Andonova, 2018: 34-38;

<sup>20</sup> Ibid, 34

<sup>21</sup> A Handbook on Reporting Terrorism, p. 21;

## 1. Para kryerjes së detyrës:

- **Keni kujdes nga stresi** me të cilin përballeni para se të kryeni ndonjë detyrë, veçanërisht nëse është një ngjarje e lidhur me EDHT. Kur niveli juaj i stresit është i lartë, ai në vetvete zvogëlon aftësinë tuaj për të mbrojtur veten;
- **Gjithmonë duhet të mbani me vete një shishe ujë** që do t'ju qetësojë dhe do t'ju kujtojë se duhet të qëndroni të qetë në situata të rrezikshme dhe të kujdeseni për sigurinë tuaj;
- **Bëni një njoftim sigurie me redaktorin** dhe telefonojeni atë sa herë që ndiheni të kërcënuar;

## 2. Gjatë kryerjes së detyrës:

- **Gjithmonë parashtroni vetes pyetjen: A jam i sigurt?**
- **Kur raportoni ngjarje kritike me pasoja serioze** ose intervistoni viktimat të ngjarjeve të tilla, **bëni një pushim sa herë që ndjeni nevojë**, pini ujë dhe siguroni ujë për bashkëbiseduesin, merrni frymë thellë dhe lejoni vetes çlirim emocional;
- **Respektoni personalitetin**, dinjitetin dhe integritetin e personit, të cilin e intervistoni;
- **Jeni të vetëdijshëm për emocionet** tuaja dhe kontrolloni ato gjatë ngjarjes.

## 3. Pas kryerjes së detyrës:

- **Shkruani të gjitha ngjarjet që i konsideroni të rëndësishme**, veçanërisht ato që ju kanë shqetësuar dhe ju kanë bërë të ndiheni të pasigurt. Diskutoni ngjarjet e tilla me kolegët tuaj dhe redaktorin;
- **Pyeteni veten, sa mirë u kujdesa** për veten dhe sigurinë time? Çfarë duhet të bëj që të mos përfundoj përsëri në të njëjtën situatë ose të ngjashme dhe si mund të përparoj në drejtim të vetëdijes time personale të sigurisë?
- **Jini të vetëdijshëm për reagimin tuaj emocional**, fizik, mendor dhe shpirtëror;
- **Kërkoni ndihmë** sa herë që ndjeni nevojë për të.



## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Benhamou, Johanna. 2020. *What guidelines should the media follow in its coverage of terrorist acts?* Issued by: International Counter-Terrorism Review.
2. Breshkovski, Ivan, Angelovski, Toni dhe Andonova, Spasenka. 2018. *Doracak për siguri të gazetarëve gjatë ngjarjeve me rrezik të lartë*. Shkup: OSBE;
3. Halbrook, Glenn. 2019. *Media Sensationalism in Today's News Coverage. And How Reporters Can Avoid It*. I mundur në: <https://www.thebalancecareers.com/media-sensationalism-in-today-s-news-coverage-2315287>, qasur më 14 prill 2021;
4. Halbrook, Glenn. 2020. *Avoiding Media Bias When Covering Political News*. I mundur në <https://www.thebalanceeveryday.com/how-to-avoid-media-bias-in-political-news-stories-2315159>, qasur më 14 prill 2021;
5. International Media Support and Media Council of Kenya. 2016. *A Handbook on Reporting Terrorism*. I mundur në [mediacouncil.or.ke/en/mck](http://mediacouncil.or.ke/en/mck), qasur më 17 prill 2021;
6. Lintner, Crissy. 2015. *Four Ways to Combat Sensationalism in the Media*. I mundur në: <https://obsidianpr.com/4-ways-to-combat-sensationalism-in-the-media/>, qasur më 21 prill 2021;
7. Komiteti nacional për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit. 2018. *Strategjia nacionale për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm*. Shkup: Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i mundur në: [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/sne\\_nacionalna\\_strategjia\\_2018.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/sne_nacionalna_strategjia_2018.pdf), qasur më 10 prill 2021;
8. Konventa për të drejtat e fëmijëve, i mundur në <http://www.childrensembassy.org.mk/WBStorage/Files/konvencija%20celosna.pdf>, qasur më 10 prill 2021;
9. Marthoz, Jean-Paul. 2018. *Terrorizmi dhe mediat. Doracak për gazetarët*. © UNESCO i Misija OSCE-a u Bosni i Hercegovini, ISBN 978-92-9234-033-9, i mundur në: (<http://www.unesco.org/open-access/terms-use-ccbysa-en>), qasur më 17 prill 2021.
10. OSCE, Mission to Bosnia and Hercegovina. 2016. *Raportimi mbi terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Udhëzime për gazetarët*. Sarajevë: Këshilli i shtypit të Bosnjë dhe Hercegovinës;
11. Spencer, Alexander. 2012. *Lessons Learnt: Terrorism and the Media* (Ser. 4). Swindon, Wiltshire: Arts & Humanities Research Council.
12. USAID. 2009. *Guide to the Drivers of Violent Extremism*. Prepared by: Guilain Denoeux with Lynn Carter, Management Systems International.



[www.znm.org.mk](http://www.znm.org.mk)